



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

Nr. 36/3 Prot.

Tiranë, më 07.10.2022

V E N D I M

Nr. 122, datë, 07. 10. 2022

PËR DHËNIE MASE DISIPLINORE

Komisioni i Policisë Gjyqësore pasi shqyrtoi në seancë dëgjimore materialet e procedimit disiplinor në ngarkim oficerit të policisë gjyqësore Hilda Myftari, dëgjoji pretendimet e saj dhe pasi analizoi çështjen në tërësi,

K O N S T A T O I:

1. Mbi kërkesën e Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiraë, nr.11908 prot., datë 01.09.2022, “Për procedimin disiplinor të oficerit të Policisë Gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Hilda Myftari”, protokolluar në Komisionin e Policisë Gjyqësore me numër protokolli 36, datë 01.09.2022,

Komisioni i Policisë Gjyqësore, në përmbushje të detyrimeve ligjore të përcaktuara në nenin 36, pika 1 e ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, ka nxjerrë Urdhërin nr. 95, datë 08.09.2022 “Për fillimin e procedimit disiplinor ndaj oficerit të policisë gjyqësore të Seksionit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, Hilda Myftari, për kryerjen e shkeljeve disiplinore në formën : “Braktisja e punes ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë”, parashikuar nga ligji nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, **neni 33, pika 3, gërma “b”**.

2. Nga përmbajtja e kërkesës së Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiraë, dhe Relacioni shoqërues, rezulton se si bazë për kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor ka shërbyer mungesa e pajustificuar në punë për më shumë se 3 ditë nga ana e oficeres së Policisë Gjyqësore, Hilda Myftari.

Nga aktet që u administruan gjatë seances dëgjimore për procedimin disiplinor, u provua se:

Oficerja e Policisë Gjyqësore Hilda Myftari ushtron funksionet e oficerit të Policisë Gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë, në seksionin e ekzekutimeve të vendimeve penale.

Drejtuesi i prokurorisë, gjatë evidentimit të listëprezencës së punonjësve për muajin Korrik, 2022, të përpiluar nga Drejtuesi i Seksionit të Ekzekutimeve, ka konstatuar se oficerja e Policisë Gjyqësore Hilda Myftari ka kryer mungesa në punë për 9 ditë. Nga listprezenca e paraqitjes në punë të punonjësve të Prokurorisë Tiranë, për muajin Korrik, rezulton se oficerja e Policisë Gjyqësore nuk është paraqitur në vendin e punës në datat 19 deri në 22 Korrik 2022 dhe 25 deri në datën 29 Korrik 2022. Për këto mungesa oficerja e Policisë Gjyqësore Hilda Myftari nuk ka njoftuar Drejtuesin e Seksionit, për shkakun e tyre dhe as nuk ka paraqitur pranë institucionit raport mjekësor për justifikimin e mungesës në punë për këtë periudhë.

Nisur nga ky fakt, është kryer printimi nga sistemi i kontrollit elektronik të hyrjeve dhe daljeve në institucionin e Prokurorisë, i oficeres së Policisë Gjyqësore Hilda Myftari, nga e cila ka rezultuar se ajo ka mungesa të përsëritura në punë, sipas datave të cituara më lart.

**3.** Nga tërësia e materialeve të administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, analiza e tyre dhe shpjegimet e vetë subjektit të proçedimit disiplinor, vërtetohet se nga ana oficerit të policisë gjyqësore Hilda Myftari, janë shkelur dispozitat e Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, që rregullojnë mardhëniet midis oficerit të Policisë Gjyqësore dhe institucionit ku ai bënë pjesë, dhe aktet ligjore që rregullojnë disiplinën në punë të punonjësve të administratës publike dhe institucioneve shtetërore. Sikurse rezulton nga aktet e administruara gjatë shqyrtimit të proçedimit disiplinor, oficerja e Policisë Gjyqësore Hilda Myftari nuk është paraqitur në vendin e punës, pa arsye të justifikuara për 9 ditë. Sikurse u provua nga listprezenca e paraqitjes në punë të punonjësve të Prokurorisë Tiranë, për muajin Korrik, oficerja e Policisë Gjyqësore Hilda Myftari nuk është paraqitur në vendin e punës në datat 19 deri në 22 Korrik 2022 dhe 25 deri në datën 29 Korrik 2022.

**4.** Në çmim të Komisionit, mosparaqitja në detyrë pas shkaqe të justifikueshme, për 9 ditë, përbën shkelje disiplinore, të parashikuar nga neni 33 i ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Komisioni vlerëson se mosparaqitja në detyrë pa shkaqe të justifikueshme, për 9 ditë rresht, përbënë shkelje disiplinore në formën, **“braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë”**, parashikuar nga **neni 33, pika 3, gërma “b” e ligjit 25/2019** “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”.

Ligji 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore”, në nenin 33, i titulluar “Shkeljet disiplinore”, parashikon sjelljet dhe veprimet apo mosveprimet e oficerëve të Policisë Gjyqësore, që konsiderohen si shkelje disiplinore. Po ky ligj në pikën 3, gërma “b”, të nenit 33 parashikon si shkelje disiplinore të rëndë, braktisjen e punës ose mungesën e pajustificuar dhe të vijueshme për më shumë se 3 ditë të oficerit të Policisë Gjyqësore. Sikurse u vërtetua gjatë zhvillimit të proçedimit disiplinor, Oficerja e Policisë Gjyqësore, Hilda Myftari ka munguar në punë, pa justifikim dhe në mënyrë të vijueshme për 9 ditë rresht.

**4.1.** Lidhur me këtë shkelje, Oficeri i Policisë Gjyqësore, Hilda Myftari, e pranon pjesërisht duke shpjeguar se ka munguar në punë për 5 ditë dhe jo 9 ditë, sikurse parashtrohet në

propozimin e drejtuesit të prokurorisë Tiranë. Lidhur me shkaqet e mungesave në punë, shpjegoi se gjatë atyre ditëve ka patur fëmijët të sëmurë dhe më pas është sëmurur dhe vetë. Pranoi se nuk ka njoftuar për këto mungesa në punë as drejtuesin e seksionit dhe as drejtuesin e prokurorisë. Gjithashtu shpjegoi se nuk ka paraqitur në institucionin ku punon raport mjekësor ose ndonjë dokument tjetër për të justifikuar mungesat në punë.

Shpjegimet dhe pretendimet e oficerit të policisë gjyqësore Hilda Myftari, nuk justifikojnë shkeljen e kryer dhe mungesat e vijueshme në punë. Ato ngelen thjesht në kuadrin e pretendimeve të pa provuara prej subjektit të proçeduar për sa kohë nuk shoqërohen me akte dhe prova që provojnë këto pretendime.

5. Duke e konsideruar të provuar shkeljen disiplinore të kryer nga oficeri i policisë gjyqësore Hilda Myftari, Komisioni, për caktimin e llojit të masës disiplinore ndaj tij, i referohet ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Ligji i sipërcituar, në nenin 33 i klasifikon shkeljet disiplinore të kryera nga oficerët e policisë gjyqësore në tre kategori:

- a) Të lehta;
- b) Të rënda;
- c) Shumë të rënda.

Po ky ligj, në gjermën “b”, pika 3, e nenit 33, parashikon si **shkelje të rënda**, “braktisja e punës ose mungesa e pajustificuar dhe e vijueshme për më shumë se 3 ditë”.

Për caktimin e masës disiplinore ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore, Hilda Myftari, Komisioni merr në konsideratë llojin dhe natyrën e shkeljes disiplinore të kryera prej saj, rrethanat e dala gjatë shqyrtimit, etj.

Gjithashtu Komisioni i referohet parashikimeve të ligjit 25/2019“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore” për parashikimet që ai bën për masat disiplinore, në raport me shkeljen e kryer.

Ligji i sipërcituar, në nenin 34 në pikën 1, parashikon llojet e masave disiplinore duke i klasifikuar sipas radhës, a) vërejtje me shkrim, b) vërejtje ma paralajmërim, c) ulje në detyrë me afat nga tre muaj deri në një vit, ç) pezullim nga detyra deri në 6 muaj dhe d) largim nga detyra ose çdo masë tjetër e barasvlefshme me të.

Në pikën 3 të nenit 34 parashikohet që për shkeljet e rënda jepet masa disiplinore “ulje në detyrë me afat nga tre muaj gjer në një vit”.

Referuar dispozitave ligjore të sipërpërmendura dhe shkeljes konkrete të kryer, Komisioni çmon që ndaj oficerit të Policisë Gjyqësore Hilda Myftari të japë masën disiplinore “zbritje në detyrë për tre muaj”, parashikuar nga neni 34, pika 1, gjërma “c” e ligjit 25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”.

Për sa më sipër, në bazë të neneve 10, shkronja “”ç”,11, pika 4, nenit 33, pika 2, gjërmat “a”, dhe “c”, neni 34, pika 1, gjërma “b”, dhe neni 38 të Ligjit nr.25/2019 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore”, Komisioni i Policisë Gjyqësore me katër vota pro.

## VENDOSI:

1. Oficerit të policisë gjyqësore Hilda Myftari, me detyrë oficer i policisë gjyqësore në Seksionin e Policisë Gjyqësore të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë , i jepet masa disiplinore **“Zbritje në detyrë për tre muaj”**.
2. Me këtë vendim , të njihet oficeri i policisë gjyqësore Hilda Myftari, e cila, në bazë të nenit 39 të ligjit 25/2019, “Për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore, ka të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative.
3. Kopje të këtij vendimi i dërgohen Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.
4. Vendimi të administrohet në dosjen personale të oficerit të policisë gjyqësore Hilda Myftari.

### KOMISIONI I POLICISË GJYQËSORE

KRYETARI

ALFRED PROGONATI

ANËTAR

ARJAN MUÇA

ANËTAR

HARI GOGO

*Mungon*



ANËTAR

REDI VASILI

ANËTAR

ALBERT MUÇO